

AKT THEMELIMI DHE STATUT

I SHOQËRISË

“ VENEZIA AGROTURIZEM ” SHPK

KAPITULLI I

KRIJIMI, FORMA, QELLIMI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, EMËRTIMI, SELIA

NENI 1

KRIJIMI I SHOQËRISË

1. Sot ne date 05/ 11 / 2024 themelohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emertimin “ **Venezia Agroturizem** ” shpk, (Me poshte referuar si “Shoqeria”).
2. Shoqeria eshte person juridik shqiptar dhe funksion ne perputhje me kerkesat e ligjit nr.9901 date 14.04.2008 “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare “ te ndryshuar.
3. Shoqeria gezon te drejta si person juridik shqiptar qe prej dates, ne te cilen organet kompetente kane dhene aprovimin per themelimin e saj.
4. Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara në dokumentat themeluese.

NENI 2

FORMA E SHOQËRISË

1. Shoqëria do të ketë formën e shoqërisë me pergjegjesi te kufizuar, për sa kohë që Ortaket e kesaj shoqerie nuk do të marrin një vendim për shndërrimin e saj.
2. Veprimtaria e shoqërisë do të rregullohet sipas radhes nga dispozitat e ketij statuti dhe dispozitat përkatëse të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”, te ndryshuar, per aq kohe sa dispozitat e ketij statuti nuk vijne ne kundërshtim me ligjin e mesiperm.


NENI 3

EMËRTIMI

Emërtimi i shoqërisë është **Venezia Agroturizem** ” shpk . Në të gjitha aktet dhe dokumentet e nxjerra nga shoqëria, emërtimi i shoqërisë do të ndiqet nga fjalët “Shoqëri me Pergjegjesi te Kufizuar” ose inicialet sh.p.k .

NENI 4

SELIA E SHOQERISE



1. Shoqëria e ka selinë ne qytetin e Tiranës, ne adresen: **Njesia Bashiake nr 5 , Rruga Faik Konica Zona kadastrale 8160 , pasuria nr 6/121-N38** . Përveç veprimtarisë në nivel lokal, shoqëria ka të drejtën e krijimit dhe mbylljes së filialeve, agjencive dhe zyrave të përfaqësimit brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
2. Selia mund të transferohet në çdo vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me një vendim të Asamblese se Ortakut te vetem te kesaj shoqerie.

NENI 5 **KOHËZGJATJA**

1. Kohëzgjatja e shoqërisë është pa afat.
2. Në përputhje më këtë statut, shoqëria mund të mbyllë veprimtarinë e saj ne cdo kohe e kur e shoh të arsyeshme, apo në rastet e parashikuara nga ligji.

NENI 6 **QELLIMI DHE OBJEKTI**

1. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:
Agroturizem , Struktura Akomoduse dhe sherbimi , Bar Kafe, restorant . Veprimtari ne fushen e bujqesise dhe blegtorise , Import – Eksport Tregti te mallrave buqesor e industrial , veprimtarive te tjera qe nuk jan parashikuar ne kete akt themelimi dhe qe lejohen nga ligjet Shqiptare .
2. Shoqeria mund te ndryshoje dhe te shtoje ne cdo kohe objektin e veprimtarise se saj sipas rregullave te parashikuara ne statutin e saj dhe ne legjislacionin tregtar.

KAPITULLI II


KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT DHE KALIMI I KUOTAVE

NENI 7 **KAPITALI THEMELTAR**

1. Kapitali themeltar i shoqerise eshte ne vleren 500,000 (peseqind mije) leke. Ai mund te rritet me vendim te asamblese se pergjithshme te ortakut te vetem sipas normave te fushes ne fuqi.

NENI 8 **ORTAKET DHE KUOTAT**

Shoqeria perbehet nga 1 ortak. Ortaku i vetem i shoqerise eshte zoti . Zhezair xhemal Lamaj i biri i Xhemalit shtetas shqiptar, madhor, me zotesi juridike per te vepruar, banuese ne adresen ,, Njesia Administrative nr 2 ,Rruga Skerdilajd Llagami Nd 3,H 1,Ap1, 1010 Tirane me numer identifikimi personal, F30819015N. Ortaku i vetem Zoti Zhezair Lamaj , zoteron 1 kuote ne masen 100%, me vlere 500,000 (peseqindmije) leke



N E N I 9
MENYRA E FITIMIT DHE KALIMIT TE KUOTAVE

1. Kuotat e kapitalit shoqerise e te drejttat dhe detyrimet qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:
 - a. Kontributit te ortakeve ne kapitalin e shoqerise;
 - b. Shitblerjes;
 - c. Trashegimise;
 - d. Dhurimit;
 - e. Çdo menyre tjeter parashikuar ne ligj.
2. Ne rastet e kalimit te kuotave me kontrate, kushtet dhe momenti i kalimit te titullit te pronesise mbi kuotat, si dhe kushtet e tjera te kalimit, perfshire momentin e pageses se cmimit, rregullohen nga kontrata.
3. Kontrata per kalimin e kuotes hartohet ne forme shkresore dhe noterizimi nuk perben kusht per vlefshmerine apo regjistrimin e kontrates.
4. Me perjashtim te rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palet bien dakord ne kontrate, vlefshmeria e kalimit te titullit te pronesise mbi kuotat nuk do te kushtezohet nga kryerja e formaliteteve te ndryshme me efekt deklarativ, perfshi ketu formalitetet e regjistrimit ose te publikimit te kontrates apo te kalimit te titullit.
5. Me perjashtim te kalimit te kuotave nepermjet trashegimise, ne rastet e tjera ortaket duhet te miratojne me vendim te asamblese, transferimin e kuotave jashte shoqerise. Pas momentit te kalimit te kuotave me ane te trashegimise, per trashegimtarete zbatohen dispozitat e parashikuara ne piken 3-10 te ketij neni.
6. Ortaket ne rastin kur mendojne qe te transferojne pjeserisht apo teresisht kuotat e tyre nepermjet shitblerjes duhet te kryejne proceduren e parablerjes se kuotave ndaj te ortakeve te tjere. Afati qe secili nga ortaket duhet te vleresoje oferten eshte 90(nentedhete) dite kalendarike nga data e marrjes se ofertes.
7. Oferta duhet te dergohet ne forme te shkruar (poste rekomande) dhe ne forme elektronike (email), ne adresen e secilit ortak te regjistruar prane shoqerise. Ortaku detyrohet te depozitoje ndryshimet e adreses se banimit prane shoqerise. Ne rastin qe ortaken nuk e kane depozituar ndryshimin prane shoqerise, ortaku qe kerkon te shese ose transferoje mund te njoftoje direkt ne adresen e shoqerise, ndaj prezumohet qe ortaket e tjere, kane marre dijeni brenda 7 diteve nga dita e mbritjes se njoftimit ne adresen zyrtare te shoqerise.
8. Oferta duhet te permbaje daten, adresen e sakte te ortakut qe i drejtohet, numrin e kuotave qe kerkon te disponoje, cmimin e ofruar per kuote dhe/ose ne total, formen e monedhes (nese eshte ndryshe nga ajo e kapitalit te regjistruar te shoqerise) dhe kursin e kembimit, kushtet e shitjes, afatin e kthimit te pergjigjes, adresen e sakte (vendin ku ortaku/et do qe te vijne pergjigjet e ofertave dhe emailin) te ortakut qe kerkon te shese kuotat. Mosrespektimi i ketyre elementeve e ben oferten te pavlefshme. Nese ortaku nuk vendos adrese ne oferte, atehere adresa eshte vendbanimi i tij zyrtar i regjistruar ne gjendjen civile, te percaktuar ne kete staut. Nese njoftimi i eshte derguar ne kete adrese, konsiderohet qe ai eshte njoftuar.
9. Nese ortaku apo ortaket e shoqerise e pranojne oferten ne kushtet e parablerjes, ata duhet te shprehen qarte dhe hapur per vullnetin e tyre te lire dhe te pakushtezuar ne pranimin e ofertes.
10. Ne rast se ortaku brenda 60 diteve kalendarike refuzon oferten ose nuk shprehet fare ne lidhje me te, atehere procedura e parablerjes konsiderohet e kryer dhe ortaku eshte i lire qe te

shese koutat e tij jashte shoqerise me nje vlere te barabarte ose me te madhe se ajo e paraqitur ne oferte.

11. Ne cdo rast, asambleja e ortakut te vetem duhet te miratoje shitjen e kuotave jashte shoqerise me shumice te cilesuar me anetaret qe jane prezente ne mbledhje, ne kete rast, vota e ortakut qe kerkon te shese kuotat, perjashtohet nga votimi.

12. Ndalohet shitja dhe/ose dhurimi i kuotave ndaj personave fizike apo juridike, veprimtaria e te cileve eshte ne konkurrence me shoqerine dhe duket hapur qe dhurimi apo shitja e tyre demton veprimtarine e shoqerise. Perjashtohet rasti, kur te gjithë ortakët e shoqerise, edhe pse sa me siper duket hapur, ata jane shprehur me vendim qe jane dakort me shitjen apo dhurimin e kuotave. Ne kete vendim, nuk perfsihet ortaku qe kerkon te shese apo dhuroje kuotat e tij.

13. Nese ortakët e tjere nuk ushtrojne te drejten e parablerjes, vec e vec dhe/ose sebashku, sipas afateve te percaktuara me lart, ortaku shites eshte i lire qe kuotat e ofruara t'ia shese te treteve, brenda 30 (tridhjetë) diteve kalendarike, nga mbarimi i afatit prej 60 ditësh kalendarike ose nga dita e kthimit te pergjigjes negative nga ortakët e tjere.

14. Ne rast se te gjithë ortakët pranojne oferten e ortakut, atehere vlera e kuotave qe jane nxjerre ne shitje, ndahet ne perpjestim te drejte, me perqindjen e ortakeve te tjere ose te barabarte nese kuotat jane te shperndara ne menyre te barabarte.

15. Ne rast se ortaku qe kerkon te shese koutat e tij pjeserisht apo plotesisht deshton ne shitjen e tyre dy here radhazi, keto kuota mund te anulohen ose te likujdohen, me miratimin e ortakut, sipas nenit 80 te Ligjit nr.9901, date. 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare". Ne cdo rast, anullimi dhe likudimi i kuotave ne fjale shoqerohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme, vendimi per anulimin ose likujdimin duhet te merret me shumice te cilesuar te anetareve prezente ne mbledhjen e asamblese.

16. Kuotat qe shiten kane vleren fillestare te regjistrimit te kapitalit fillestar, nese shoqeria deri ne momentin e fillimit te procedures se shitjes nuk bere rritje kapitali sipas ligjit dhe te regjistruar ne QKB.

NENI 10

PASOJAT E KALIMIT TE KUOTAVE, PJESTIMI DHE TRANSFERIMI I TYRE

1. Personi qe kalon kuoten dhe ai qe e perfiton ate, pergjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes , nga çasti i kalimit te kuotave, deri ne çastin e regjistrimit te kalimit, sipas pikes 2 te nenit 74 te Ligjit Per shoqerite tregtare.
2. Shoqeria realizon kalimin e kuotes, sipas nenit 43 te ligjit nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".
3. Kuotat jane lirisht te transferueshme midis ortakeve te shoqerise. Rregulli i kushtezimit te transferimit nuk zbatohet ne rast te transferimit per shkak trashegimie ose transferimit tek pjesetaret e familjes.

KAPITULLI III

MARREDHENIET NDERMJET SHOQERISE DHE ORTAKEVE

NENI 11

SHPERNDARJA E FITIMEVE



1. Ortaket kane te drejte te ndajne sipas perqindjes se pjesemarrjes ne shoqeri, pjesen e fitimit te deklaruar ne pasqyrat financiare te shoqerise dhe te miratuara nga nje ekspert kontabel i miratuar dhe prej asamblese se ortakeve me vendim. Shoqeria mund te mos ndaje fitim edhe kur realizon fitim, nese mbledhja e asamblese ka vendosur per kete qellim.
2. Administratori i shoqerise ne rastin e shperndarjes se fitimit duhet qe dokumentin perkeates qe autorizon strukturen perkatese per kalimin e fitimeve ndaj ortakeve te shoqerise, ta shoqeroje me vendimin perkates te asamblese, i cili miraton ne parim shperndarjen e vendimeve.

NENI 12

KUFIZIMET E SHPERNDARJES, ÇERTIFIKATA E AFTESISE PAGUESE, PERGJEGJESITE

1. Shoqeria mund t'u shperndaje fitim ortakeve, vetem nese pas pagimit te dividendit:
 - a. Aktivët e shoqerise mbulojne teresisht detyrimet e saj;
 - b. Shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme brenda 12-muajve ne vazhdim.
2. Administratori leshon nje çertifikate te aftesise paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shperndarja e propozuar e dividendeve permbush kerkesat e paragrafit te pare te ketij neni, ndersa kur gjendja e shoqerise tregon se shperndarja e propozuar e dividendeve nuk i permbush keto kritere, administratori nuk mund te leshoje kete çertifikate .
3. Administratori pergjigjet ndaj shoqerise per vertetesine e çertifikates se aftesise paguese.
4. Administratori, i cili nga pakujdesia leshon nje çertifikate te pasakte te aftesise paguese, pergjigjet personalisht perpara shoqerise per kthimin e dividendeve te shperndare.
5. Ortaket, qe kane mare nga shoqeria dividend, pergjigjen personalisht ndaj shoqerise per kthimin e dividendeve, pavaresisht leshimit te certifikates, nese keta ortake kane pasur dijene per gjendjen e paftesise paguese te shoqerise sipas paragrafit te pare te ketij neni.

KAPITULLI IV

ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

Organet drejtuese të shoqërisë janë:


1. Asambleja e pergjithshme e ortakut te vetem
2. Administratori

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E ORTAKUT TE VETEM

NENI 13

TE DREJTAT DHE DETYRAT

1. Asambleja e pergjithshme e ortakut te vetem eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per çeshtjet e meposhteme :




- a) Përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
 - b) Ndryshimet e statutit;
 - c) Emerimin dhe shkarkimin e Administratorit ;
 - d) Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe ekspertëve kontabel të autorizuar;
 - e) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat c dhe d, të kësaj pike ;
 - f) Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë ;
 - g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë ;
 - h) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - i) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre ;
 - j) Përfaqesimin e shoqërisë në gjykate dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit ;
 - k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë ;
 - l) Për miratimin e marrjes së audituesve të jashtëm, në rastet e hetimeve të posaçme;
 - m) Miratimin e strukturës së shoqërisë dhe nivelet e pagave për vend pune;
 - n) Shpërndarjen e fitimeve për ortakët;
 - o) Investime afatshkurtra dhe afatgjata;
 - p) Miratimin e marrjes së kredive bankare;
 - q) Krijimin dhe përdorimin e fondit rezervë të shoqërisë;
 - r) Shndërrimin e formës së shoqërisë dhe/ose bashkimin me shoqëri të tjera, apo pjesëmarrjen në shoqëri apo grupe shoqërishe;
 - s) Miratimin e formës, përmbajtjes dhe përdorimit të regjistrimit të shoqërisë për regjistrimin e vendimeve të shoqërisë, dhe strukturën përgjegjëse për administrimin e tij;
 - t) Miratimin e rregulloreve të ndryshme të punës si dhe rregulloreve të tjera që në thelb kanë të bëjnë me procese të rëndësishme të veprimtarisë së shoqërisë ;
 - u) Miratimin në rastin e shitblerjes së kuotave të ortakëve ose formave të tjera të transferimit të tyre, sipas parashikimeve të këtij statuti.
 - v) Miratimin në rastet e dhenies apo marrjes me qira të sendeve prodhuese të luajtshme.
2. Duhet regjistruar në veçanti në Qendren Kombëtare të Biznesit, por pa u kufizuar në to, vendimet e asamblese për :
- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve ;
 - c) Investime;
 - d) Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
 - e) Vendime të tjera që asambleja e përgjithshme vlerëson se duhet regjistruar.
3. Vendimet e përgjithshme të regjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundërshtojë pavlefshmerinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmerinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të kishte pasur dijeni për të .

NENI 14

MBLEDHJA E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME E ORTAKUT TË VETEM

1. Asambleja e Përgjithshme e Orakut të Vetem mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligji "Për shoqëritë tregtare", nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së Orakut të Vetem thirret të paktën 1 herë në vit.




2. Asambleja e Përgjithshme e Orakut te Vetem thirret nga administratori dhe/apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 84 të ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Nr. 9901, dt. 14.04.2008 te ndryshuar.
3. Asambleja e përgjithshme e Orakut te Vetem duhet te thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
4. Asambleja e përgjithshme e Orakut te Vetem duhet thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
5. Asambleja e përgjithshme e Orakut te Vetem duhet te thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak, pasuri që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
6. Në rastet e parashikuara në pikat 3 e 5 të këtij neni, asamblesë së përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur.
7. Dispozitat e pikës 6 të këtij neni nuk zbatohen nëse blerjet sipas pikave 4 e 5 të këtij neni, kryhen në bursë ose janë pjesë e veprimeve të përditshme të shoqërisë dhe bëhen në kushte normale tregu.
8. Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri në 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme e Orakut te Vetem mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorit.

NENI 15 MENYRA E THIRRJES

1. Asambleja e përgjithshme e Orakut te Vetem thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë poste rekomande dhe me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 (shtate) ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
2. Materialet e mbledhjes të përcaktuara në rendin e ditës duhet të dërgohen jo me vonë se 3 (tre) ditë nga dita e caktuar për zhvillimin e mbledhjes, në formë elektronike dhe me shkresë. Mosdërgimi i tyre në kohë konsiderohet si shkelje procedurës për thirrjen e asamblesë dhe mbledhja konsiderohet e pavlefshme, me përjashtim të rastit kur të gjithë ortakët janë të pranishëm në mbledhje dhe janë dakord me moszbatimin e kësaj dispozite.
3. Kur asambleja e përgjithshme e Orakut te Vetem nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

NENI 16 KERKESAT NGA ORTAKET E PAKICES

1. Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, apo një pjesë më të vogël të parashikuar në statut, mund t'i drejtojnë administratorit një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 83 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".



2. Nëse, në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:
 - a) të ngrejë padi në gjykatë, për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse administratori nuk përmbush kërkesat e ortakëve brenda 15 ditëve;
 - b) t'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tyre.
2. Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të pikave 1 e 2 të këtij neni thirrja i është njoftuar ortakëve, administratori njofton përsëri rendin e ditës, të ndryshuar, në përputhje me parashikimet ligjore dhe statutore.
3. Ndryshimet në rendin e ditës si rregull lejohen të bëhen jo më vonë se 3 (tre) ditë nga data e marrjes së njoftimit të zhvillimit të mbledhjes. Në cdo rast, para fillimit të mbledhjes lejohet që ortakët e pranishëm, ne unanimitet mund të bëjnë ndryshime në rendin e ditës.
4. Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të ortakut të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të ortakut të përfaqësuar.


NENI 17
PERFAQESIMI NE ASAMBLE

1. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi (në rastet kur ortaku është person juridik) ose prokurë të posacme (në rastet kur ortaku është person fizik) nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Në cdo rast përfaqësimi të një apo disa ortakëve, drejtuesi i mbledhjes së asamblesë duhet të verifikojë ligjshmërinë e autorizimit të përfaqësimit. Përfaqësuesit e autorizuar do të pranohen në mbledhje veten nëse autorizimi i tyre plotëson kushtet e parashikuara nga legjislacioni shqiptar mbi përfaqësimin.
2. Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
3. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

NENI 18
KUORUMI
PER VENDIMET ME SHUMICE TE THJESHTE

1. Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë me shumicë të paktën 50% (pesëdhjetë) të kuotave.
2. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje që kërkojnë shumicë të cilësuar, që parashikohen në nenin 87 të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", kuorumi i nevojshëm është ai i përcaktuar në nenin 19 të këtij statuti.
3. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet, për shkak të mungesës së kuorumit në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 19
KUORUMI
PER VENDIMET ME SHUMICE TË CILËSUAR




1. Asambleja merr vendim me $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) kur marrin pjesë në mbledhje ortaket me të drejte vote që zoterojnë me shume se 75 (shtatëdhjete e pese)% të kuotave të shoqërisë, në rastet e mëposhtme:
 - a) për ndryshimin e statutit,
 - b) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar,
 - c) shpërndarjen e fitimeve,
 - d) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë,

NENI 20
MARRJA E VENDIMEVE NDAJ ORTAKEVE

Vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në ligj ose në statut, nuk kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

NENI 21
E DREJTA E VOTES

1. Cdo ortak ka të drejta vote në përprojetim me vlerën nominale të kuotes së tij. Bashkëzotuesit e një kuote ushtrojnë të drejtat e votes bashkërisht, sipas nenit 72 të ligjit.
2. Ortakët, që nuk mund të jenë të pranishëm fizikisht në vendin ku zhvillohet mbledhja e asamblesë së përgjithshme kanë të drejtë që të përfaqësohen, ose të marrin pjesë nëpërmjet mjeteve të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet plotësisht identifikimi i ortakëve.
3. Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to:
 - a) transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale;
 - b) komunikimin e ndërsjelltë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehën për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër;
 - c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.
4. Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'u mundësuar ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve. Nëse gjatë zhvillimit të mbledhjes ndodh që të ndërpritet komunikimi mes ortakut/ve me mbledhjen për arsye teknike apo të forcave madhore, dhe ortaku apo ortakët nuk kanë përfaqësuesit e tyre fizikisht në vendin ku zhvillohet mbledhja, atëherë vendimarrja do të konsiderohet e rregullt për atë kohë sa ishte vendosur lidhja e drejtpërdrejtë me mbledhjen me ortakun dhe/ose ortakët, gjë e cila duhet shënuar në procesverbalin e mbledhjes. Asambleja me një shumicë mbi 50 % të kuotave mund të vendosë përpara zhvillimit të mbledhjes, që në mbledhje të caktuara të asamblese të jete prezent dhe një noter publik.
5. Ortakët kanë të drejtën, që u njihet nga ligji apo ky statut, për të marrë unanimisht çdo vendim, me kusht që kjo marrëveshje të bëhet me shkrim.




NENI 22
PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
 - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

NENI 23
PROCESVERBALET E MBLEDHJES SE ASAMBLESE

1. Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratori përgjigjet për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.
2. Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.
3. Procesverbalit i bashkëlidhet lista e pjesëmarrësve dhe njoftimi i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.
4. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari, nga mbajtësi i procesverbalit (sekretari) dhe të gjithë ortakët e pranishëm në mbledhje ose përfaqësuesit e tyre. Drejtuesi i mbledhjes ka detyrimin që të lejojë ortakët që të kenë të gjithë kohën e nevojshme që të shqyrtojnë procesverbalin e mbledhjes. Drejtuesi i mbledhjes ka detyrimin që të perpilojë aq kopje origjinale sa ortake janë të pranishëm në mbledhje.
5. Pas nënshkrimit të procesverbalit, duhet të përgatitet vendimi i mbledhjes, i cili duhet të përmbajë midis të tjerash, numrin e radhes, datën e mbledhjes ku është marrë vendimi, bazën ligjore dhe statutore, pjesëmarrjen dhe kuorumin, vendin e mbledhjes, shprehjen e qarte të asaj që ortakët kanë rënë dakort ose jo, pozicionimin e tyre sipas çdo pike të rendit të ditës mbi të cilën është marrë një vendim, nënshkrimin e ortakëve pjesëmarrës, në rastin kur janë persona fizike dhe vulën e shoqërisë kur janë persona juridike. Vendimi mund të zbardhet (hartohet, lexohet dhe nënshkruhet dhe/ose vulloset nga të gjithë ortakët e pranishëm), ditën e mbledhjes ose në ditën e vijimit, por në asnjë rast më vonë se 10 (dhjetë) ditë pas përfundimit të mbledhjes. Vendimi i asamblesë së ortakëve është i detyrueshëm të bëhet dhe nënshkruhet (emër, mbiemër, nënshkrim, dhe vulë nëse ortaku është person juridik) në fund të tij, në aq kopje origjinale sa janë ortakët pjesëmarrës, dhe të pakten dy kopje origjinale të tjera. Vendimi si rregull nënshkruhet nga çdo ortak, në secilën faqe, nëse ka më shumë se një faqe. Njëra prej tyre duhet të mbahet nga administratori, për tu regjistruar dhe depozituar në arkivën e shoqërisë. Kopja/et e tjera mund të perdoren për regjistrim, nëse vendimi i asamblesë së përgjithshme është parashikuar nga statuti dhe/ose nga ligji si rast i detyrueshëm regjistrimi, pranë QKB apo institucioneve publike dhe/ose jopublike që e kërkojnë një gjë të tillë.




6. Nje kopje e vendimeve mund tu dergohet me poste dhe ne forme elektronike ortakeve te cilet nuk kanë qënë pjesëmarres ne mbledhje, per tu vene ne dijeni me vendimet e asamblese se pergjithshme.
7. Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, administratori, jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, eshte i detyruar të publikojë kopje të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së pergjithshme në këtë faqe kur ka marre fillimisht qe ne mbledhjen perkatese te asamblese miratimin per publikim per çdo mbledhje ne veçanti.

NENI 24 **HETIMET E POSAÇME**

1. Asambleja e pergjithshme mund të vendosë nisjen e një hetimi të posaçëm për parregullsitë pergjate veprimeve të themelimit të shoqërisë apo të ushtrimit të veprimtarisë tregtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës, i cili miratohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme sipas parashkimeve te ketij statuti.
2. Ortakët që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë, apo një vlerë më të vogël të parashikuar në statut dhe/ose cilido kreditor i shoqërisë mund t'i kërkojnë asamblesë së pergjithshme emërimin e një eksperti të pavarur të fushës, kur ka dyshime të bazuara për shkelje të ligjit ose të statutit.
3. Ortakët apo kreditorët e shoqërisë së përcaktuar më sipër, brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për emërimin e ekspertit të pavarur, mund t'i kërkojnë gjykatës emërimin e këtij eksperti. Nëse asambleja e pergjithshme nuk merr një vendim brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, kërkesa e ortakëve vlerësohet e refuzuar.
4. Kur asambleja e pergjithshme ka emëruar një ekspert të fushës për kryerjen e hetimit të posaçëm dhe kur për këtë emërim ka dyshime të bazuara për të besuar se eksperti mund të mos realizojë hetimin e posaçëm në mënyrën e duhur, ortakët ose kreditorët e përmendur në pikën 2 të këtij neni mund t'i kërkojnë gjykatës zëvendësimin e tij.
5. Kur gjykata pranon kërkesat e përmendura në pikat 2 e 3 të këtij neni, shoqëria tregtare përballon kostot e emërimin dhe të shpërblimit të ekspertit të emëruar për kryerjen e hetimit të posaçëm.
6. E drejta për të kërkuar hetim të posaçëm, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, duhet të ushtrohet brenda 3 vjetëve nga data e regjistrimit të shoqërisë tregtare, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e procesit të themelimit, si dhe brenda 3 vjetëve nga data e veprimit, që konsiderohet i parregullt, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e ushtrimit të veprimtarisë tregtare.
7. Kreditori, që në keqbesim paraqet një kërkesë, sipas pikës 2 të këtij neni, pergjigjet në përputhje me nenin 34 të Kodit të Procedurës Civile.

NENI 25 **SHFUQIZIMI I VENDIMEVE TE PARREGULLTA DHE DEMSHPERBLIMI**

1. Asambleja e pergjithshme, ne baze te nje vendimi te marre me shumicen e percaktuar sipas pikes 2, neni 87, te ligjit, ka te drejte te ngrëje padi perpara gjykatës kompetente per shfuqizimin e vendimeve te administratoreve, si pasojë e shkeljes se rende te ligjit ose te



statutit dhe/ose padi te tjera qe parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratoreve apo ortakeve.

2. Ortaket, te cilet perfaqesojne te pakten 5 per qind te totalit te votave ne asamblene e shoqerise ose nje vlere me te vogel, te parashikuar ne statut, dhe/ose kreditorët e shoqerise, te cilet pretendojne se shoqeria ka ndaj tyre detyrime ne nje vlere jo me te vogel se 5 per qind te kapitalit, mund t'i kerkojne asamblese se pergjithshme ngritjen e padise per shfuqizimin e vendimeve te administratoreve. Ortaket apo kreditorët e shoqerise se percaktuar me sipër, brenda 30 diteve pas refuzimit nga asambleja per ngritjen e padise, kane te drejte te ngrene drejtperdrejt, perpara gjykates kompetente, padi ne emer te shoqerise, per shfuqizimin e vendimit te administratoreve. Nese asambleja e pergjithshme nuk merr nje vendim, brenda 60 diteve nga data e kerkeses, kerkesa e ortakeve apo kreditorëve te percaktuar me sipër vleresohet e refuzuar."
3. Asambleja e pergjithshme ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës përkatëse shfuqizimin e vendimeve të administratorëve, kur këto përbëjnë shkelje të rëndë të ligjit ose të statutit.
4. Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asambleshë e shoqërisë, ose një vlerë më të vogël të parashikuar në statut, apo secili prej kreditorëve të shoqërisë mund t'i kërkojnë asamblesë së pergjithshme ngritjen e padisë si më sipër. Ortakët apo kreditorët e shoqërisë së percaktuar më sipër, brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për ngritjen e padisë, kanë të drejtë të ngrenë padi drejtperdrejt përpara gjykatës kompetente për shfuqizimin e vendimit të administratorëve. Nëse asambleja e pergjithshme nuk merr një vendim, brenda 60 ditëve nga data e kërkesës, kërkesa e ortakëve apo kreditorëve vlerësohet e refuzuar.
5. Në rastet kur shoqëria ngre padi si më sipër, ajo merr pjesë në gjykim me anë të një përfaqësuesi të posaçëm, të caktuar nga asambleja e pergjithshme.
6. Ortakët ose kreditorët e përmendur në pikën 2 të këtij neni mund t'i kërkojnë gjykatës zëvendësimin e përfaqësuesit të posaçëm, kur ka dyshime të bazuara se përfaqësuesi i emëruar nga asambleja e pergjithshme mund të mos ngrejë e ndjekë padinë në interesin më të mirë të shoqërisë. Nëse gjykata e pranon këtë kërkesë, kostot e emërimit dhe të shpërblimit të përfaqësuesit përballohen nga shoqëria.
7. Gjykata vendos shpalljen e pavlefshmërisë së vendimit të administratorëve, nëse këta nuk merren vesh, me pajtim, me përfaqësuesin e posaçëm për korrigjimin e pasojave të vendimit, brenda 30 ditëve nga data e emërimit të këtij përfaqësuesi. Të drejtat e palëve të treta mbeten të pacenuara, në përputhje me pikën 3 të nenit 12 të këtij ligji.
8. Ortakët në pakicë dhe kreditorët e percaktuar më sipër kanë të drejtat e parashikuara në pikat 2 e 4 të këtij neni, edhe në rastin kur asambleja e pergjithshme nuk merr vendim, ose refuzon të vendosë për kërkesën e tyre për ngritjen ndaj administratorëve të padisë, me objekt shpërblimin e dëmit të pësuar nga shoqëria, si vendim i paligjshëm, apo për ngritjen e padive të tjera që parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratorëve apo ortakëve.
9. Dispozita e paragrafit të gjashtë të nenit 91 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" zbatohet edhe për këto padi.

NENI 26
TE DREJTAT E LIDHURA ME KUOTEN

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave.


NENI 27
NDALIMI I KUFIZIMEVE

1. Janë të pavlefshme dispozitat e statutit, që kufizojnë ose përjashtojnë ndonjë nga të drejtat e ortakëve ose të kreditorëve, sipas përcaktimeve të bëra në nenet 91, 92 e 93 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", si dhe dispozitat, që parashikojnë kufizime të përgjithshme të veprimeve të përcaktuara në këto nene.
2. Vendimet e asamblesë së përgjithshme nuk mund të cenojnë të drejtën e ortakëve ose të kreditorëve për të kryer veprimet e parashikuara në nenet 91, 92 e 93 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

ADMINISTRATORI

NENI 28
EMERIMI, SHKARKIMI, TE DREJTAT DHE DETYRIMET

1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, i cili caktohet në statut, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 (pese) vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Asambleja e Përgjithshme merr vendim të posacem për riemërimin e Administratorit pas periudhes së emerimit të pare. Emerimi i administratoreve, i cili hyn në fuqi në datën e përcaktuar sipas aktit të emerimit, u kundërvetohet paleve të treta sipas përcaktimeve të nenit 12 të ligjit tregtar.
2. Administrator i shoqërisë është Zoti Zhezar Lamaj , i biri Xhemalit , shtetas shqiptar, lindur në 19/08/1953 , madhore, me zotësi juridike për të vepruar, banuese në Tiranë, në adresë : **Njesia Administrative nr 2 ,Rruga Skerdilajd Llagami Nd 3,H 1,Ap1, 1010 Tiranë**, me numer identifikimi personal, F30819015N .
3. Caktimi i Administratorit bëhet nga ky statut për një periudhë 3 (tre) vjetecare me të drejtë riemërimi nga Asambleja e Ortakëve. Asambleja zgjedh administratorin e saj me shumicë
4. Administratori mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar asamblese së përgjithshme. Administratori, që jep dorëheqjen, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarisë së shoqërisë, është gjithashtu i detyruar të thërrasë asambelën e përgjithshme për emërimin e administratorit të ri, përpara datës në të cilën dorëheqja të hyjë në fuqi.
5. Nëse asambleja e përgjithshme nuk vendos emërimin e administratorit të ri në datën e përcaktuar në thirrjen e kryer nga administratori i dorëhequr, atëherë administratori i



njofton me shkrim doreheqjen Qendres Kombetare te Regjistrimit, se bashku me kopjen e thirrjes se mbledhjes se asamblese se pergjithshme dhe Qendra Kombetare e Regjistrimit regjistron largimin e administratorit, sipas procedurave te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007, "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", te ndryshuar.

6. Doreheqja e administratorit nuk cenon padite e shoqerise per shkelje te detyrimit te besnikerise qe administratori ka ndaj saj, sipas ketij ligji."

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare ne marrëdhënie me te tretet;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) njoftoje ortakët për mbledhjen e shoqerise me kerkese te tij ose te njerit ose disa prej ortakëve;
- e) mbaje nje rregjister te vecante ku te beje rregjistrimin e te gjitha vendimeve te Asamblese se Pergjithshme. Te mbaje te gjithë dokumentacionin e nevojshem qe duhet per cdo mbledhje, pervec te tjerave, njoftimin per thirrjen e mbledhjes, procesverbalin dhe vendimin e asamblese te nenshkruar nga te gjithë ortakët pjesemarrës, dhe dokumentat shoqeruese qe jane diskutuar ne mbledhje;
- f) mbaje lidhje te ngushta me ortakët dhe te respektojë etiken ne komunikim dhe marrëdhënie me ta.
- g) lidhe kontratat e punes me punonjesit e shoqerise;
- h) mbaje korespondence te rregullt me te tretet, si dhe te marre te gjitha masat qe kjo te jete e arkivuar ne arkiven e shoqerise;
- i) siguroje akses te lire dhe te pakushtezuar per secilin prej ortakëve, qe te njihet me cdo dokument qe keta te fundit e vleresojne te rendesishme ne mbarevajtjen e veprimtarise se shoqerise;
- j) raportoje me shkrim ndaj asamblese se pergjithshme per veprimtarine tremujore te shoqerise, edhe nese asambleja apo secili prej ortakëve nuk e ka kerkuar shprehimisht kete raport. Ky raport duhet te dergohet me shkrim dhe i nenshkruar nga administratori, zyrtarisht me poste dhe/ose me poste elektronike, ne adrese te ortakëve te shoqerise.
- k) përgatise dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- l) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- m) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- n) raportoje përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- o) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në kete statut.

Në rastet e parashikuara nga pikat 3 e 5 të nenit 82 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", administratori është i detyruar të thërrase asamblesën e përgjithshme.

NENI 29
PERFAQESIMI




1. Kufizimet e tagrave të përfaqësimit të administratorit i kundrejtohen palëve të treta, në përputhje me dispozitat e nenit 12 të këtij ligji.
2. Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tij njoftohet për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 30 **SHPERBLIMI**

1. Shpërblimit bazë të administratorit mund t'i bëhen shtesa. Shtesat bëhen me vendim të posaçëm të asmblesë së ortakëve sipas nenit 86 të Ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
2. Shpërblimi, sipas pikës I të këtij neni, duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorit, gjendjen financiare të shoqërisë dhe të respektojë nivelet minimale të kërkuara nga legjislacioni në fuqi.
3. Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, asambleja e përgjithshme mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorit në masën e përshtatshme.
4. Kriteret e shpërblimit, shpërblimi individual dhe efekti vjetor i shpërblimit të administratorit në strukturën e kostove të shoqërisë tregtare publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

NENI 31 **DETYRIMI I BESNIKERISË DHE PERGJEGJESIA**

1. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", administratori detyrohet:
 - a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
 - d) të garantojë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të pikës 3 të nenit 13 të Ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".këtij ligji;
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave të mesiperme të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ai apo personat e lidhur me të kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara.



4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryen veprimet e mëposhtme:

- a) i kthen ortakëve kontributet;
- b) i paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) i shpërndajnë aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

5. Dispozitat e pikës 6 të nenit 92 të këtij ligji zbatohen edhe për paditë, që rrjedhin nga paragrafët e këtij neni. Këto padi duhet të ngrihen brenda 3 (tre) vjetëve nga kryerja e shkëljes apo nga zbulimi i saj.

TITULLI V PRISHJA E SHOQËRISË, LARGIMI DHE PËRJASHTIMI I ORTAKËVE

KREU I

PRISHJA E SHOQËRISË


NENI 32

SHKAQET E PRISHJES SE SHOQERISE

1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

- a) kur mbaron kohezgjatja, për të cilën është themeluar;
- b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
- c) në rast se objekti bëhet i përealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
- d) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 i ligjit tregtar;
- e) në raste të tjera, të parashikuara në statut;
- f) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
- g) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.

2. Prishja e shoqërisë, si pasoje e një apo me shumë prej shkaqeve të përcaktuara në shkronjat "a", "c", "d", "dh" dhe "e", të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga asambleja e ortakëve me shumicën e parashikuar sipas pikës 1, të nenit 87, të këtij ligji.



3. Ne rast mosveprimi te asamblese se ortakeve per te vendosur prishjen, per shkaqet e percaktuara me siper, cdo person i interesuar mund, ne cdo kohe, t'i drejtohet gjykates per te konstatuar prishjen e shoqerise.

4. Pavaresisht nga parashikimet e siperpermendura, ekzistenca e nje a me shume shkaqeve, te parashikuara ne kete nen, nuk do te kete si pasoje prishjen e shoqerise dhe hapjen e procedurave te likuidimit, nese perpara vendimit gjyqesor te formes se prere, shkak i prishjes eshte korrigjuar, nese eshte e mundshme te korrigjohet, dhe ky korrigjim eshte publikuar nga shoqeria ne regjistrin tregtar, sipas parashikimeve te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007, "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", te ndryshuar.

5. Prishja e shoqerise, si pasoje e shkaqeve te parashikuara ne shkronjen "b", te pikes 1, te ketij neni, vendoset nga gjykata kompetente per procedurat e falimentimit, kur, ne perfundim te ketyre procedurave, te gjitha pasurite e shoqerise jane likuiduar per shlyerjen ne menyre kolektive te detyrimeve ndaj kreditorëve apo kur gjykata kompetente per procedurat e falimentimit vendos rrezimin e kerkeses per hapjen e procedurave se falimentimit per shkak te pamjaftueshmerise se pasurise se shoqerise per te mbuluar shpenzimet e procedurave se falimentimit.

6. Prishja e shoqerise si pasoje e shkaqeve te parashikuara ne shkronjen "c", te ketij neni, vendoset nga gjykata kompetente, sipas parashikimeve te nenit 3/1 te ligjit tregtar.

NENI 33

REGJISTRIMI I SHPERBERJES

1. Administratori ka detyre te regjistroje shperberjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Nëse prishja e shoqërisë bëhet me vendim gjykate, gjykata, në përputhje me nenin 45 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" ia njofton vendimin Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim.
2. Ne rastin e shperberjes se shoqerise, pavaresisht institucionit qe ka marre vendimin asamblese dhe/ose gjykates, ngarkohet administratori qe te kryeje procedurat deri ne perfundim te ketij procesi, per aq kohe sa, kjo dispozite e statutit nuk vjen ne kundërshtim me legjislacionin ne fuqi.

KREU II

LARGIMI DHE PËRJASHTIMI I ORTAKËVE

NENI 34

LARGIMI I ORTAKUT PER SHKAQE TE ARSYESHME

1. Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë.
2. Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtrijë shkaqet e largimit.

3. Administratori duhet të thërrase mbledhjen e asamblesë së përgjithshme menjëherë pasi të ketë marrë dijeni për njoftimin e largimit, sipas pikës 2 të këtij neni, për të vendosur nëse ortakut do t'i anulohet dhe/ose likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme.
4. Ortaku ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit asambleja e përgjithshme nuk mblidhet apo nuk njih si të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotës.
5. Ortaku që largohet ka të drejtë të ngrejë padi ndaj shoqërisë dhe/ose ortakëve të tjerë që shkaktuan largimin e tij dhe të kërkojë ndaj tyre, në mënyrë solidare, shpërblimin e dëmit të pësuar.

NENI 35
PERJASHTIMI I ORTAKUT

1. Asambleja e përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës përjashtimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përjashtim.
2. Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e ortakut, sipas pikës 1 të këtij neni, por pa u kufizuar në to, rastet kur ortakut:
 - a) me dashje apo me pakujdesi të rëndë i shkakton dëme shoqërisë ose ortakëve të tjerë;
 - b) me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj;
 - c) përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut; ose
 - d) me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë.
 - e) Mungon për me shume se dy mbledhje rresht në asamblet e përgjithshme, duke mos marrë pjesë personlisht e as me perfaqesues, në mënyrë të pa justifikuar, dhe pa njoftim paraprak, megjithatë ka pasur njoftim të rregullt sipas parashikimeve të këtij statuti.
3. Gjatë procedurës së përjashtimit të ortakut, me kërkesë të paditësit, gjykata mund të marrë një masë për sigurimin e padisë, duke pezulluar të drejtën e votës së ortakut, që kërkohet të përjashtohet, si dhe të drejtat e tjera, që rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, kur ajo e vlerëson këtë masë si të nevojshme dhe të justifikuar.
4. Shoqëria ka të drejtë t'i kërkojë ortakut të përjashtuar shpërblimin e dëmit të pësuar nga veprimet, që kanë sjellë përjashtimin.
5. Ortaku ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë shpërblimin e dëmit të pësuar, nëse kërkesa për përjashtim nuk është e bazuar.
6. Ortaku nuk ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë likuidimin e kuotës, nëse ai përjashtohet për shkaqe të arsyeshme, por, nëse shoqëria ngre ndaj tij padi për shpërblim dëmi, ortakut ka të drejtë të kompensojë çdo shumë, që do të kishte të drejtë ta përfitonte në cilësinë e likuidimit të kuotës, me dëmin e kërkuar nga shoqëria.

NENI 36
PASOJAT E LARGIMIT DHE PERJASHTIMIT

Shënohi Ramo

1. Të gjitha të drejtat që rrjedhin nga cilësia e ortakut në shoqëri, shuhen në datën e largimit ose të vendimit të formës së prerë të gjykatës për largimin ose përjashtimin.

2. Statuti nuk mund të përjashtojë apo të kufizojë të drejtën e ortakut për t'u larguar nga shoqëria dhe të drejtën e shoqërisë për të përjashtuar ortakun.

NENI 37

LIKUIDIMI NE GJENDJEN E AFTESISE PAGUESE

Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, sipas neneve 190 deri në 205 të këtij ligji.

NENI 38

Dispozita tranzitore dhe te fundit

1. Per cdo gje qe nuk eshte parashikuar shprehimisht ne kete statut qe lidhet me funksionimin e shoqerise, zbatohet legjislacioni shqiptar ne fuqi ne momentin e nenshkrimit te ketij satuti.
2. Ne cdo rast kur legjislacioni shqiptar perkates mund te ndryshoje, ky statut me vendim te asamblese se ortakeve, sipas rregullave te percaktuara mund te ndryshohet, ne perputhje me ndryshimet perkatese te legjislacionit ne fuqi.
3. Ky statut hartohet ne tre kopje origjinale, dhe hyn ne fuqi per palet nenshkruese nga data e nenshkrimit te tij dhe prodhon efekte ndaj te treteve nga data e rregjistrimit te tij ne QKB.

ORTAKU THEMELUES

Zhezair Xhemal Lamaj

Emer Mbiemer Firme

